



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLI

Nr. 553/ 9 prot.

Datë 29.04.2022

V E N D I M
Nr. 411/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Argent Daci*” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-16642-12-29-2021*, në 7 lote me objekt “*Blerje artikuj ushqimor*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 1,061,007,405 (*një miliard e gjashtëdhjetë e një milion e shtatë mijë e katërqind e pesë*) Lekë (pa TVSH) ose 8,815,282.53 (*tetë milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e tre*) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 29.12.2021 është 120.36 lekë)., **Loti 3** me Nr. *REF-16650-12-29-2021*, me objekt “*Blerje mish dhe nënproduktet e tij*” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj, me fond limit 314,572,580 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Olta Sharra*” PF në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “Argent Daci” PF.
Adresa: Rruga “Abdi Bej Toptani”, godina nr. 21, poshtë kthesës së Valiasit, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Olta Sharra” PF.
Adresa: , Rruga “Ismail Zyra”, Lagjja “Haxhias”, zona kadastrale 8525, objekti me numer pasurie A, Elbasan.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi ,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30-12-2021, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-16642-12-29-2021, në 7 lote me objekt “*Blerje artikuj ushqimor*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 1,061,007,405 (një miliard e gjashtëdhjetë e një milion e shtatë mijë e katërqind e pesë) Lekë (pa TVSH) ose 8,815,282.53 (tetë milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e tre) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 29.12.2021 është 120.36 lekë), **Loti 3** me Nr. REF-16650-12-29-2021, me objekt “*Blerje mish dhe nënproduktet e tij*” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj, me fond limit 314,572,580 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 11.02.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 03.03.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Olta Sharra” PF	245,832,119	lekë	kualifikuar
- “Argent Daci” PF	276,269,406	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 03.03.2022 operatori ekonomik “*Argent Daci*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

“OE “Argent Daci” PF, nuk plotëson pikën 6, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në SPE nuk ka paraqitur të deklaruar sipas tabelës nr. 1, kontratat e furnizimit me operoret me të cilët do të përmbushë kërkesat e AK për artikujt objekt prokurimi.”.

II.5. Në datën 08.03.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 32, me datë 15.03.2022.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 16.03.2022, operatori ekonomik ankimues “Argent Daci” PF, ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij, si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Olta Sharra” PF me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me datë 30.12.2021, ka publikuar në sistemin elektronik të APP-së procedurën “E Hapur”, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomik (e ri hapur). Loti 3 “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 314,572,580 lekë pa TVSh me Nr. REF - 16650-12-29-2021.

Më datë 03.03.2022 jemi njohur nëpërmjet sistemit elektronik të APP-së për Vlerësimet për tenderin Loti 3 “Blerje mish dhe nënproduktet e tij” (Faza e vlerësimit të tenderit), ku rezulton si më poshtë:

- “Olta Sharra” PF	245,832,119	lekë	kualifikuar
- “Argent Daci” PF	276,269,406	lekë	skualifikuar

Shoqëria jonë është s'kualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

“OE “Argent Daci” PF, nuk plotëson pikën 6, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në SPE nuk ka paraqitur të deklaruar sipas tabelës nr. 1, kontratat e furnizimit me operoret me të cilët do të përmbushë kërkesat e AK për artikuajt objekt prokurimi.”.

Më datë 15.03.2022 sipas buletinit nr. 32 jemi vënë në dijeni lidhur me Formularin e Njoftimit të Operatorëve Ekonomike të Suksesshëm në Marrëveshje Kuadër (para procesit të ankimimit), mbi të cilin është kualifikuar shoqëria “Olta Sharra” PF dhe skualifikuar shoqëria jonë. Njoftimi i klasifikimit është bërë me datën 03.03.2022 dhe publikimi i njoftimit është bërë më datën 15.03.2022 mbi të cilin fillojnë dhe afatet e ankimimit sipas përcaktimeve të Kreut XIV, Ankimi administrativ, në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, Afatet e ankimit ku parashikohet se: “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit paraqesim ankesën.

I. Sa i përket arsyes së skualifikimit shoqëria jonë sqaron se:

Referuar pikës 6, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: 6. “Ne rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të veproj me kontrata furnizimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen dhe operatorët me të cilët janë lidhur këto kontrata duhet ta ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionin në fuqi.

Vendimi për skualifikim është i pabazuar dhe për rrjedhojë i kundërligjshëm, ardhur si pasojë ose e mos shqyrtimit të dokumentacionit tonë ose/dhe e ndonjë vendimi të paracaktuar për skualifikim të kompanisë sonë dhe kualifikim e konkurrentit tjetër. Në interpretim të kriterit të vendosur nga autoriteti kontrakti kërkohet paraqitja e dokumentacionit vetëm në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi. Nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar dokumentacion vetëm në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues, por do të veproj me kontrata furnizimi. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës, objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Një ndër parimet kryesore të ushtrimit të veprimtarisë së administratës publike është ai i ligjshmërisë, e cila ndër të tjera, duke marrë për bazë edhe parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative nënkupton se të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. Në rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit datë 19.11.2018, III Hartimi i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit parashikohet se:

a.2 Theksojme se gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor do të mbaje në konsideratë faktin se nuk lejohet përdorimi i licenses se një operatori tjetër ekonomik.

b. Në rastet kur, operatorët ekonomike nuk kanë detyrimin ligjor të licencohen nga QKB duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jete i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

Shoqëria jonë është prodhues në fushën e objektit të prokurimit dhe plotëson kriterin e sipërcituar pasi vetëm po të shohim faqen e QKB-së shkruhet fare qartë që jemi prodhues ku veç të tjerash në objektin e veprimtarisë thuhet: Thertore. Tregtie mishi. Shitje —Blerje lekurosh. Tregti me shumicë e kafshëve të gjalla. Import-eksport. Veprimtari në fushën e prodhimit, magazinimit e tregtimit me shumicë e pakicë të prodhimeve blegtorale dhe bujqësore. Tregti, import, eksport duke përfshirë edhe magazinimin dhe tregtimit me shumicë e pakicë të mallrave

ushqimore blegtoral e bujqësore... Prodhim e tregtim e të gjitha llojeve të ndryshme të sallamit, nënproduktet e sallamit, mishit dhe nënprodukteve e tij...

Gjithashtu për të vërtetuar këtë fakt “prodhues” nga ana jonë kemi dorëzuar në sistemin elektronik licencat si më poshtë:

1. LN-6726 02-2019

Kodi: II.1.A

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Mish dhe nënprodukte të tij). (veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim, e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” (Mish dhe nënprodukte të tij)

2. LN-2936-09-2021

Kodi II.1.A

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Thertore (ne veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Thertore).

3. LN-0324-10-2015

Kodi II.1.B

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz).

Në rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit datë 19.11.2018 në shtojcën 1, përcaktohet kategorizimi i operatorëve ekonomik që prodhojnë, përpunojnë dhe shpërndajnë ushqime me origjinë shtazore dhe joshtazore. Nga ana jonë disponohet LN-2936-09-2021 Kodi II.1.A Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Thertore, siç shihet dhe në shtojcën 1, kategoria është prodhim primar. Autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit se: nuk plotëson pikën 6, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në SPE nuk ka paraqitur të deklaruar sipas tabelës nr. 1, kontratat e furnizimit me operatorë me të cilët do të përmbush kërkesat e AK për artikujt objekt prokurimi nuk ka përcaktuar, pse nuk plotësohet ky kriter nga ana jonë. Çfarë dokumentacioni duhet të paraqitet kur një operator ekonomik është prodhues dhe cili do të ishte dokumentacioni që do bindte AK për plotësim e kriterit pika 6 ku siç shihet qartë nuk është kërkuar paraqitja e ndonjë dokumentacioni në rast se operatorët ekonomik është prodhues. Referuar ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM me nr. 538, date 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar (Aneksi I, Fusha II, Kategoria II.1, Kreu III, në pikat 12, 14 të tij), si dhe Shtojcës I të “Rekomandimit të përbashkët Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit datë 19.11.2018, drejtuar Autoriteteve Kontraktore mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikimin dhe specifikimet për prokurimin e produkteve ushqimore arsyetojmë se:

Shoqëria jonë është prodhues në fushën e mishit dhe përputhet 100% me objektin e prokurimit, sipas Shtojcës I të cilën po ja u vendosim në dispozicion ku shpjegohet qartë se Kategoria kryesore e origjinës së produktit Shtazor është Licenca me Kodin A.1, Kategoria kryesore “Prodhim primar”, Kodi i veprimtarisë specifike A.1.1, Nën Kategoria “Thertore”.

Ndodhur në këto kushte shoqëria jonë nuk ka pasur nevojë dhe detyrim për të lidhur kontratë furnizimi pasi ajo në kuptimin e ligjit është prodhues i produktit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor sipas objektit të prokurimit.

Sipas Urdhrit datë 31.12.2021 të Ministrit të Bujqësisë (institucionit përgjegjës e mbikëqyrës ndaj operatorëve ushqimor për kontrollet zyrtare, është qartësisht e pa asnjë ekuivok klasifikimi si kategori për operatorët prodhues (më poshtë faksimile e urdhrit dhe faqes përkatëse bashkëlidhur këtij urdhri).

Ne baze të dokumentacionit tone të dorëzuar në SPE vertetohet se shoqëria jonë ushtron veprimtari prodhim e tregtim mishi sipas objektit të kontratës. Edhe nëse për një moment supozojmë se thertorja nuk është prodhues mishi, logjikisht menjëherë përballëmi me absurdin kush është prodhues mishi?? ABP nuk ka shqyrtuar dokumentacionin ligjor të paraqitur nga ana jonë por ka refuzuar ofertën tone ekonomike për mosplotësim kriteresh që i përkasin operatorëve jo prodhues.

Në Dokumentet Standardë të Tenderit, seksioni 2.2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomike thuhet:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhimi, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1. B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datën 19.11.2018).

Me anë të licencave të dorëzuara nga shoqëria jonë

1. LN-6726 02-2019

Kodi: II.1.A

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Mish dhe nënprodukte të tij). (veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim, e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” (Mish dhe nënprodukte të tij)

2. LN-2936-09-2021

Kodi II.1.A

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Thertore (në veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Thertore).

3. LN-0324-10-2015

Kodi II.1.B

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz).

Vërtetohet qartë se përmbushet kriteri dhe të treja licencat janë të lidhura drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit Loti 3 “Blerje mish dhe nënprodukte të tij”. Sipas objektin të QKB-së si dhe disponimit të treja licencave vërtetohet se jemi prodhues, përpunues, dhe shitës së produkteve objekt prokurimi. Për të vërtetuar dhe me tej faktin “prodhues” i jemi drejtuar Autoriteti Kombëtar të Ushqimit për interpretim ku kërkojmë: “Mbi bazën e këtyre licencave zotëruara prej nesh si dhe legjislacionit në fuqi, shoqëria jonë a quhet “Prodhues” në fushën e mishit dhe nënprodukteve të tij”.

Me shkresën nr.1494/1 prot, datë 15.03.2022 Autoriteti Kombëtar të Ushqimit shprehet se: Subjekti Argent Daci kryen aktivitet prodhues/përpunues të produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij (për njerëz) në fushën e ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi. Sa me sipër, vërtetohet qartësisht se jemi prodhues dhe plotësojme kriterin e kualifikimit. Autoriteti Kontraktor duhet të kuptojë që shoqëria jonë nuk është në kushtet e nenit 84 të Ligjit 162/2020, nuk është në kushte që duhet të punojë me kontrata furnizimi për sa kohë kryen aktivitet prodhues/përpunues të produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij (për njerëz) në fushën e ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi. Në rast se Autoriteti Kontraktor do të kërkonte kontrata furnizimi me feramat agrolektorale të cilat merren me shitjen e kafsheve të gjalla (gje e cila nuk është objekt prokurimi por gjithsesi mund të shërbente për gjurmueshmerinë e produktit) ajo duhet të kërkojë tek dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor nuk mund të kërkojë asnjë kriter shtesë pas publikimit të tyre. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë ekonomike vetëm mbi kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër mbështetur në Ligjin 162/2020, datë 23.12.2020, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Ligjin nr.10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar VKM me nr. 538, datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, “Rekomandimit të përbashkët Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit datë 19.11.2018, shoqëria jonë plotëson pikën 6, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi klasifikohet si prodhues, nuk ka nevojë për kontrata furnizimi sipas objektit të prokurimit “Blerje mish dhe nënprodukte të tij” dhe si e tillë kërkojmë: Kualifikimin e ofertës sonë.

II. Në këtë procedurë prokurimi Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik Olta Sharra PF i cili nuk përmbush kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor konkretisht nuk plotëson kriteret:

A. Nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti profesional, Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Në dokumentet standardë të tenderit, seksioni 2.2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë thuhet: a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me

shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1.B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018). Argumentimi “Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Nga verifikimi në ëeb-in në Qendrën Kombëtare të Biznesit, lidhur me licencat aktive, të kategorisë II.1.A subjekti “Olta Sharra” PF, zotëron licencat e mëposhtme:

1. LN-0459-04-2020

Kodi: II.1.A

Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhimi, përpunim, ambalazhim, etiketim, shpërndarje të produkteve ushqimore. Kufizime specifike: Paketim, ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell).

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021, Nenit 40, pika 5, “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon

a) Licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Pra, licencat profesionale përkufizimin e mallrave duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Licenca e mësipërme nuk është në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nenproduktet te tij” pasi ka kufizime specifike dhe shërben për paketimin, ambalazhimin e produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell). Sa me sipër, kjo licence nuk përmbush piken 2.1 Kapaciteti Profesional dhe operatori ekonomik Olta Sharra PF duhet s’kualifikuar.

2. LN-0077-02-2020

Kodi: II.1.A

Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Shërbim Catering).

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021, Nenit 40, pika 5, “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon.

a) Licencat profesionale për prodhimin dhe ose/furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Pra, licencat profesionale për furnizimin e mallrave duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Licenca e mësipërme nuk është në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nënproduktet te tij” pasi ka kufizime specifike dhe shërben për paketimin, ambalazhimin e produkteve ushqimore (Shërbim katering).

Sa me sipër, kjo licence nuk përmbush piken 2.1 Kapaciteti Profesional dhe operatori ekonomik Olta Sharra PF duhet s’kualifikuar.

3. LN-9102-02-2015

Kodi: II.1.A.

Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Katering)

Referuar VKM nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 40, pika 5, “5, Për të provuar përshtatshmerine për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkoi.’

a) Licencat profesionale per prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shtetere;”

Pra, licencat profesionale për furnizimin e mallrave duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Licenca e mësipërme nuk është në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nënproduktet te tij” pasi ka kufizime specifike dhe shërben për paketimin, ambalazhimin e produkteve ushqimore (Shërbim katering).

Sa më sipër, kjo licencë nuk përmbush pikën 2.1 Kapaciteti Profesional dhe operatori ekonomik Olta Sharra PF duhet s’kualifikuar.

Për një informacion mbi licencat dhe sqarim të tyre më datë 24.02.2022 i jemi drejtuar me shkresë Autoritetit Kombëtar i Ushqimit ku i kemi kërkuar sqarim lidhur me:

1. Informacion/sqarim lidhur me kufizimet e licencave për ushtrimin e veprimtarisë. A mundet që një subjekt me licence me kodin II.1.A, me përshkrimin e veprimtarisë “Katering”, “Bar Restorant”, “Ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell) ose “Furrë buke” mund të ushtrojë normalisht aktivitetet për shitjen e mishit të freskët ?

2. Për të qartësuar autoritetet kontraktore në vlerësimin e kritereve lidhur me këtë objekt veprimtarie kërkojmë një informacion/sqarim nga ana juaj se kush quhet prodhues në fushën e tregtimit të mishit dhe nën produkteve te tij si dhe kush janë licencat e nevojshme për të qenë prodhues në këtë fushë ?

Me shkresën nr. 411/I prot dalë 04.03.2022, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sqaron se: 1. Në bazë të ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar (Aneksi I, Fusha II, Kategoria II.I, Kreu III, në pikat 12, 14 të tij), Licencat me kodin II.1.A me

aktivitet Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz “Restorant”, “Katering”, “Bar-Restorante”, “Furrë buke” etj. janë licenca me veprimtari specifike për aktivitetin perkates si “Restorant”, “Katering”, “Bar-Restorante”, “Furrë buke” etj. dhe nuk kanë të bëjnë me tregtimin e mishit të freskët.

Pra, licencat e mësipërme nuk janë në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nenproduktet te tij” pasi emërtimin përshkrues të veprimtarisë e kanë për (sheqer, oriz, miell) dhe për shërbim katering sikurse është shprehur qartë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në pikën I të shkresës nr. 411/1 prot datë 04.03,2022, “...Licencat me kodin II.1.A me aktivitet Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz “Restorant”, “Katering”, “Bar-Restorante”, “Furrë buke” etj. nuk kanë të bëjnë me tregtimin e mishit të freskët.

Sa më sipër, operatori ekonomik nuk plotëson kriterin seksioni 2.2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomike thuhet: Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe duhet të s’kualifikohet,

B. Operatori ekonomik i kualifikuar nuk zotëron licencat përkatëse për të qenë prodhues dhe tregtuesi mishit dhe nënprodukteve të tij, dhe me qëllim plotësimin e kriterëve për kualifikim ka lidhur kontratat e furnizimi me operatorë me të cilët do të përmbush kërkesat e AK për artikujt objekt prokurimi.

Kontrata e furnizimit duhet të jetë lidhur me një prodhues në fushën e mishit dhe nën produkteve të tij, pra me një thertore. Nëse operatori ekonomik Olta Sharra PF ka dorëzuar kontratën e furnizimit me thertoren është e pakuptimtë që autoriteti kontraktor kualifikon një operator ekonomik i cili ka lidhur një kontrate furnizimi me një thertore dhe s’kualifikon një operator ekonomik i cili disponon thertore vet. Nëse shoqëria “Olta Sharra” PF ka dorëzuar licencën e saj LN-9900-01-2020, me kodin Kodi: II.1.C, Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim primar fruta-perime, dhe autoriteti kontraktor është bazuar vetëm mbi këtë licence, theksojmë se:

a) Prodhimi primar fruta perime nuk ka lidhje me objektin e prokurimit dhe nëse do të ishim në rastin që autoriteti kontraktor për shkak të gjurmueshmërisë së produktit do të kërkonte licencën me kodin II.3.A, i cili lidhet me mbarshtrimin e kafshëve në fermat agrolektorale duhej të paraqitej në kriteret e tenderit sipas legjislacionit përkatës. Pra në të dyja rastet nuk mund të jetë kjo licencë kualifikuese për këtë procedurë tenderimi.

b) Nëse shoqëria “Olta Sharra” PF ka dorëzuar kontrata furnizimi me subjekte të cilat zoterojnë licencën me kodin II.3.A me Emërtimin Përshkrues të Veprimtarisë: Mbarështrim i kafshëve në fermat agrolektorale të medha, ato kontrata janë të panevojshme dhe nuk përmbushin asnjë nga kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor. Duke qenë se Prodhues në fushën e mishit (objekt prokurimi) njihet vetëm ‘thertorja’ atëherë cdo kontratë tjetër e paraqitur nga subjekti “Olta Sharra” PF është e panevojshme dhe nuk përmbush asnjë nga kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Nisur nga dyshimi i arsyeshëm (pasi fushën e tregtimit të mishit jemi shumë pak subjekte të cilat plotësim kushtet), subjektet të cilat ka lidhur kontrata furnizimi i operatorit ekonomik Olta Sharra PF nuk kanë paraqitur formulari i vecantë i Vetëdeklarimit pasi nuk mund të plotësojnë kriteret dhe ndodhen në kushte të përjashtimit pasi kanë problematika të ndryshme dhe të gjitha deklaratat e përmbledhura në shtojcën 8 janë në kundërshtim me kushtet aktuale të këtyre subjekteve. Ndodhur në këto kushte operatori ekonomik Olta Sharra PF nuk i ka dorëzuar ato dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 84 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”. Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor duhet të s’kualifikoje operatorin ekonomik Olta Sharra PF për mosplotësim të deklaratave të sipër përmendura.

C. Në kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet: 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A. 1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1.B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, për çdo stabiliment që disponon (pronesi dhe/ose qira) të paraqes tabelën me informacion si më poshtë:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrimit të posaçëm
1		Pronesi/qira/përdorim	
Etj.		Pronesi/qira/përdorim	

Detyrimisht duhet që çdo stabiliment duhet të jetë i pajisur me licence përkatëse. Në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këto nën do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenin 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Stabilimenti/stabilimentet që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Nga verifikimi i ekstraktit të shoqërisë Olta Sharra PF shohim vendet e ushtrimit të aktivitetit janë:

1. Elbasan Lagjja Haxhias, rruga Ismail Zyra, zona kadastrale 8525, objekti me numer pasurie A.
2. Elbasan Labinot fushe MENGEL Rruga Elbasan-Librashd, zk.2654, pasuria nr. A
3. Elbasan Labinot fushe Labinot fushë Rruga Elbasan-Labinot fushe, zk.2355, pasuria nr. 483/1

4. Elbasan Elbasan ELBASAN Lagjja Luigj Gurakuqi, rruga 11 Nentori, zona kadastrale nr. 8521, pasuria nr. 7/83, kati 1.

Referuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, objekt me numër pasurie A nuk ekziston dhe si e tillë adresa e objektit është e pasaktë. Sa me sipër, operatori ekonomik Olta Sharra PF nuk i ka paraqitur të gjitha stabilimentet që zotëron sipas ekstraktit, ky kriter është i papërbushur dhe Autoriteti Kontraktor duhet të s'kualifikoje operatorin ekonomik.

D. Duke ndjekur historikun e veprimtarisë së operatorit ekonomik ndër vite nëpërmjet Buletinit të Agjencisë së Prokurimit Publik njoftim fituesi apo lidhje kontrate kemi bindjen se operatori ekonomik Olta Sharra nuk plotëson kriterin furnizime të ngjashme, kontrata dhe fatura tatimore vlera e të cilave nuk e përmbush 40% e kontratës që prokurohet, sipas pikës 2.3 Kapaciteti Teknik ku citohet:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Referuar shtojcës 2 “lista e çmimeve” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Loti 3 “Blerje mish dhe nënproduktet e tij” rezulton se autoriteti kontraktor kërkon të furnizohet me artikujt Mish Pule, cilësi e parë, Mish Pulë Deti cilësi e parë, Mish Gjel Deti cilësi e parë, Mish Viçi cilësi e parë, Mish Derri cilësi e parë, Mish Gici cilësi e parë, Mish Keci cilësi e parë, Mish Qengji cilësi e parë, Mish i grirë Viçi cilësi e parë, Sallam Vici cilësi e parë, Sallam Derri cilësi e parë, Sallam popullor Vici cilësi e parë, Sallam popullor Derri cilësi e parë, Fileto pule cilesi e parë.

Referuar historikut të veprimtarisë së operatorit ekonomik ndër vite kryesisht ka lidhur kontrata shërbimi catering apo shërbim ushqime koloniale në kontrata bashkëpunimi me operator të tjerë kemi bindjen se ky operator nuk plotëson kriterin furnizime të ngjashme në vlerën 40% te vlerës së fondit limit pasi kontratat e realizuara nuk përmbajnë zëra të procedurës objekt prokurimi si dhe zëra të cilët nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit.

Duke qenë se objekti i prokurimit është “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, atëherë dhe dëshmitë për furnizime e mëparshme të ngjashme duhet të kenë lidhje “mishin dhe nënproduktet

të tij”. Operatori ekonomik Olta Sharra PF nisur nga licencat që zotëron dhe objekti i veprimtarisë sipas ekstraktit vepron në fushën e “Katering” dhe shërbim ushqimor kolonial dhe rrjedhimisht pjesën më të madhe të faturave e ka për shërbime katering. C’ka do të thotë se kjo shoqëri nuk mund të përmbushë kurrësi vlerën e parashikuar sipas kriterit më sipër me dëshmi për furnizime të ngjashme, pasi faturat për shërbimin katering nuk mund të quhen furnizime të ngjashme me prodhimin, shitjen dhe tregtimin e mishit.

Autoriteti kontraktor në llogaritjen e vlerës dëshmive për furnizime të ngjashme duhet të heqë të gjitha ato të cilat nuk kanë as minimumin e ngjashmerisë me tregtimin e mishit.

Për sa më sipër operatori ekonomik Olta Sharra PF nuk ka kapacitetet e nevojshme për të plotësuar dëshmi për furnizime të ngjashme në vlerën e 40% të fondit limit siç përshkruhet në kriter, dhe si të tillë duhet s’kualifikuar.

E. Gjithashtu operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi disponimin e të paktën 6 (gjashtë) automjete ATV (frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Duke ndjekur historikun e veprimtarisë së operatorit ekonomik të kontratave të lidhura nga ky operator kemi bindjen që nuk disponon në pronësi 6 mjete automjete ATV (frigorifer), për transportin e mallrave dhe plotësimi i këtij kriteri për këtë procedurë prokurimi do të jetë plotësuar nëpërmjet marrjes me qira ose përdorim të mjeteve dhe si të tilla nuk plotësojnë kriterin sipas nenit 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar pasi operatorit ekonomik që kanë mjete automjete ATV (frigorifer), lejet qarkullimit të tyre në 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve janë lëshuar vetëm për transport për mjete dhe jo për të tretë, si rrjedhim nuk mund të përdoren nga operatore të tjerë ekonomik.

Për sa më sipër operatori ekonomik Olta Sharra PF nuk plotëson kriterin mbi disponimin e të paktën 6 (gjashtë) automjete ATV (frigorifer), dhe si të tillë duhet s’kualifikuar.

F. Operatori ekonomik Olta Sharra pf nuk plotëson kriterin për pikën 4 të 2.3 të Kapaciteti teknik ku për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar punëtorë të thjeshtë 6 punëtorë, për të cilët kërkohet kontrata të punës përkatëse.

Në kriteret e kualifikimit për këtë kriter përcaktohet se :

Shënim: Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet në staf të 1 punonjësi, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimorë , brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Referuar LPP ku parimi i të gjitha kriterëve të kërkuar nga autoriteti kontraktor kanë të bëjnë me objektin e prokurimit. C’ka do të thotë ky kriter i shërbën autoritetit kontraktor për të garantuar se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën.

Sa më sipër, duke pasur parasysh dhe historikun e veprimtarisë së operatorit ekonomik ndër vite ku kryesisht ka lidhur kontrate shërbimi Catering apo shërbim ushqime koloniale kemi bindjen, se ky operator nuk plotëson kriterin mbi stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Akoma me tej Ak kërkon që punonjësit të jenë të regjistruar në listëpagesat e shoqërisë, kemi bindjen që Operatori nuk i ka të regjistruar punëtorët sipas Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës Kombëtare të Profesioneve (LKP)” e rishikuar.

Për sa më sipër operatori ekonomik Olta Sharra PF nuk plotëson kriterin mbi disponimin e 6 puntorëve të thjeshtë dhe si e tillë duhet s’kualifikuar.

Ndodhur në këto kushte shoqëria jonë kërkon:

- 1. Kualifikimin e operatorit ekonomik ARGENT DACI PF*
- 2. Skualifilimin e operatorit ekonomik Olta Sharra PF*

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 553/2 prot., datë 16.03.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes “Argent Daci” PF, për të cilat ngrihen pretendime, si dhe kriteret të cilat operatori ekonomik ankimes “Argent Daci” PF pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës “Olta Sharra” PF.

II.8. Në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, me shkresën nr 472 prot, datë 23.03.2022 pranë autoritetit kontraktor dhe me shkresën nr. 553/3 prot, datë 23.03.2022 pranë Komisionit Prokurimit Publik janë paraqitur argumente nga operatori ekonomik i interesuar “Olta Sharra” PF, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 553/4 prot., datë 25.03.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Argent Daci” PF.

II.10. Me shkresën nr. 488/1 prot., datën 25.03.2022, protokolluar me tonën me nr. 553/5 prot., datë 29.03.2022, me objekt “*Vënie në dijeni mbi zgjatjen e afatit për shqyrtimin e ankesës*”, si dhe me shkresën nr. 532/1 prot, datë 30.03.2022, protokolluar me tonën me nr. 553/6 prot., datë 31.03.2022, me objekt “*Kthim-përgjigje*”, depozituar pranë Komisionit Prokurimit Publik, është njoftuar Komisioni Prokurimit Publik dhe është vënë në dijeni operatori ekonomik ankimues, në lidhje me ndërprerjen e afateve të shqyrtimit të ankesës, si nevojë e kryerjes së verifikimeve pranë institucionit kompetent nga ana e autoritetit kontraktor.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me shkresën nr. 488 prot., datën 24.03.2022, protokolluar pranë Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 1792 prot., datë 24.03.2022, me objekt “*Kërkesë për informacion*”, me përmbajtje si vijon: “Pranë ABP-së është paraqitur ankesë nga operatori “*Argent Daci*” PF me pretendimin se ky ofertues është prodhues për produktet mish dhe nënproduktet e tij. Operatori ekonomik a disponon stabilimente apo njësi në Sistemin e Informacionit Blektorale dhe Veterinar “*Ruda*” për prodhimin e produkteve si më poshtë: *Mish pule cilësi e parë, Mish pule deti cilësi e parë, Mish gjel deti cilësi e parë, Mish vici cilësi e parë, Mish deri cilësi e parë, Mish gici cilësi e parë, Mish keci cilësi e parë, Mish qengji cilësi e parë, Mish i grirë vici cilësi e parë, Kremvice cilësi e parë, Sallam vici cilësi e parë, Sallam derri cilësi e parë, Sallam popullor vici cilësi e parë Sallam popullor derri cilësi e parë, Proshutë vici cilësi e parë, Proshutë derri cilësi e parë, Fileto pule cilësi e parë*. Nëse po ju lutem na vendosni në dispozicion licencat përkatëse.

Me shkresën nr. 1792/1 prot, datë 01.04.2022 me objekt “*Kthim-përgjigje, kërkesës për informacion për operatorin ekonomik “Argent Daci” PF, në lidhje me regjistrimin e tij në sistemin “RUDA”, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural citon se: “Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 488, datë 24.03.2022, me kërkesë për informacion në lidhje me operatorin ekonomik “Argent Daci”, nëse është i regjistruar në sistemin RUDA, ju bëjmë me dije se operatori është i regjistruar me tip njësi thertore, për therje të kafshëve të llojit gjedh dhe të imta, me kod njësie AL11341649T001, si dhe fermë blegtorale me kod fermë AL113416490520”*.

II.11. Me shkresën nr. 597 prot., datën 08.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 553/7 prot., datë 08.04.2022, me objekt “*Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt Loti III Blerje mish dhe nënproduktet e tij*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*Argent Daci*” PF, në të cilën konstatohet, se me vendimin nr. 450/2 datë 07.04.2022, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF. Me shkresën nr. 450/3 prot, datë 08.04.2022 me objekt “*Dërgim vendimi mbi ankesën*”, është njoftuar operatori ekonomik ankimues dhe është vënë në dijeni Komisioni Prokurimit Publik.

II.12. Me shkresën datë 27.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 553/8 prot., datë 28.04.2022, me objekt “Në vijim të shqyrtimit të ankesës nr. 553/2022 prot, datë 16.03.2022” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion dhe dokumentacion provues nga operatori ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi me përmbajtje ndër të tjera si më poshtë vijon.

Me shkresën e datës 11.04.2022, protokolluar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 2201 prot, datë 13.04.2022 me objekt kërkesë për informacion me përmbajtje ndër të tjera si vijon:

[...] Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë informacion gjithashtu nga ana juaj, nëse subjekti im Argent Daci PF i cili zotëron licencat e shënuara më sipër, a quhet “Prodhues” në fushën e mishit dhe nënprodukteve të tij? [.....].

Me shkresën nr. 1494/1 prot., datën 15.03.2022, me objekt “Kthim-përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion”, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndër të tjera sqaron se: “*Për sa më sipër cituar Subjekti Argent Daci kryen aktivitetet prodhues/përpunues të produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij (për njerëz) në fushën e ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi*”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se: “*OE “Argent Daci” PF, nuk plotëson pikën 6, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në SPE nuk ka paraqitur të deklaruar sipas tabelës nr. 1, kontratat e furnizimit me operatoret me të cilët do të përmbushë kërkesat e AK për artikujt objekt prokurimi*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pika 2.3.6 “*Kapaciteti Teknik*” në dokumentet standarde të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

ISHTE

6. Në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të veproj me kontrata furnizimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen dhe operatorët me te cilet janë lidhur keto kontrata duhet ta ushtrojne aktivitetin e tyre konform legjislacionit ne fuqi.

BËHET

6. Në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të përmbush kërkesat e AK me kontrata furnizimi për të gjithë artikujt objekt prokurimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen sipas tabelës nr 1. Operatoret palë të këtyre kontratave furnizimi duhet ta ushtrojne aktivitetin e tyre konform legjislacionit ne fuqi .

Tabela 1

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi I Artikullit</i>	<i>Prodhuesi/Distributori I autorizuar</i>	<i>Data e nenshkrimit te fillimit të kontratës se furnizimit</i>	<i>Data e perfundimit te afatit kontratës se furnizimit</i>
1				
2				
3				
4				
5				
Etj				

Shënim:

Operatori ekonomik fitues duhet te sjelle kopjet e kontratave te deklaruarra sipas tabelës nr 1, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e fituesit perfundimtar.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Argent Daci” PF në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar .
- Deklaratë për ambientet në disponim pika 2.1, nën-pika 1 me përmbajtje si vijon: Shoqëria “Argent Daci” PF ka në disponim ambientin sipas tabelës së mëposhtme në të cilin

ushtron veprimtarinë e tij (Kamëz, Tiranë, (statusi në përdorim); Zk 2066, nr. pasurie 60/33, volum. 68, faqe 46).

- Deklaratë për kontrollin nga autoriteti AKU në subjektin tonë më datë 18.01.2022 me nr. AKU-TR-2021-0060149 lidhur me licencën II.1.B. Procesverballi i Inspektimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Gjithashtu nga kontrolli i fundit në subjektin tonë më datë 04.11.2021 me nr. AKU-TR-2021-006312 lidhur me licencën II.1.A, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Për sa më sipër shoqëria jonë deklaron se nga kontrolli i fundit i ushtruar nga AKU ka rezultuar se subjekti jonë ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.
- Akt Miratim Higjeno Sanitar me nr. serial 000232, datë 28.10.2019 me adresë Rruga “Abdi Bej Toptani godina 21 poshtë kthesës së Valiasit, me aktivitet Prodhim, përpunim dhe tregtim i mishit dhe produkteve të tij.
- Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-2936-09-2021 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Thertore. Vendi kryerjes veprimtarisë Tiranë, Kamëz, rruga Abdi Bej Toptani, godina nr. 21, poshtë kthesës së Valiasit.
- Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-6726-02-2019 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Mish dhe nënproduktet e tij). Vendi kryerjes veprimtarisë Tiranë, Kamëz, rruga Abdi Bej Toptani, godina nr. 21, poshtë kthesës së Valiasit.
- Licencë me Kodin II.1.B LN-0324-10-2015 me emërtim përshkrues të veprimtarisë (Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz). Vendi kryerjes veprimtarisë Tiranë, Kamëz, rruga Abdi Bej Toptani, dyqan poshtë kthesës së Valiasit.

III.1.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Në nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes” është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë”.*

III.1.7. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.*

III.1.8. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht:

Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinarë

6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjiëno-sanitare.

III.1.9. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III.1.10. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë

pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.11. Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë se *në rast se nuk janë prodhues, por do të përmbush kërkesat e AK me kontrata furnizimi për të gjithë artikujt objekt-prokurimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen sipas tabelës nr. 1. Operoret palë të këtyre kontratave furnizimi duhet ta ushtrojne aktivitetin e tyre konform legjislacionit ne fuqi.* Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin licencë të kategorisë II.1.A Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz dhe licencë të kategorisë II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) të lëshuar nga QKB. Akoma më tej, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me ligjin, do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 te ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF në përmbushje të kriterit sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriter - *Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-2936-09-2021 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Thertore. Vendi kryerjes veprimtarisë Tiranë, Kamëz, rruga Abdi Bej Toptani, godina nr. 21, poshtë kthesës së Valiasit. - Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-6726-02-2019 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Mish dhe nënproduktet e tij). Vendi kryerjes veprimtarisë Tiranë, Kamëz, rruga Abdi Bej Toptani, godina nr. 21, poshtë kthesës së Valiasit. - Licencë me Kodin II.1.B LN-0324-10-2015 me emërtim përshkrues të veprimtarisë (Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz). Vendi kryerjes veprimtarisë Tiranë, Kamëz, rruga Abdi Bej Toptani, dyqan poshtë kthesës së Valiasit. KPP vëren, se ankimuesi ka paraqitur licencat përkatëse nga verifikimi i të cilave rezulton emërtimi përshkrues i veprimtarisë se tyre është **1- Thertore, 2- Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Mish dhe nënproduktet e tij), 3- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz.** Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik Argent Daci PF është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon statusit të prodhuesit të mishit dhe nënprodukteve të tij ndaj dhe nuk është e nevojshme paraqitja e kontratave të furnizimit për sa kohë që ky operator referuar dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe kthim përgjigjes së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara citon se: “*Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 488, datë 24.03.2022, me kërkesë për informacion në lidhje me**

*operatorin ekonomik “Argent Daci”, nëse është i regjistruar në sistemin RUDA, ju bëjmë me dije se operatori është i regjistruar me tip njësi thertore, për therje të kafshëve të llojit gjedh dhe të imta, me kod njësie AL11341649T001, si dhe fermë blegtorale me kod fermë AL113416490520”. Sa i takon arsyes së skualifikimit dhënë nga autoriteti kontraktor për ankimuesin, se ky i fundit nuk ka deklaruar kontratat e furnizimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret ka tejkalluar kërkesat në kriterin e veçantë të kualifikimit, në të cilin ka kërkuar nga ana e ofertuesve të deklarojnë kontratat e furnizimit nëse ata nuk janë prodhues, kërkesa këto të cilat referuar arsyetimit sa më sipër janë përmbushur nga ana e ankimuesit. Ndërkohë KPP gjykon, se fakti që subjekti ka deklaruar në ekstraktin e regjistrimit tregtar ushtrimin e veprimtarisë së thertores, tregti mishi, tregti kafshësh, veprimtari në fushën e prodhimit të magazinimit e tregtimit të prodhimeve blegtorale dhe bujqësore, prodhim i të gjitha llojeve të sallamit nënproduktet e sallamit, mishit dhe nënproduktet e mishit, si dhe ka paraqitur licencat përkatëse për ushtrimin e këtyre veprimtarive, qartësisht arrihet në konkluzionin se operatori ekonomik ankimues ndodhet në rolin e prodhuesit dhe nuk është e nevojshme paraqitja e dokumentacionit si kontrata furnizimi, për sa kohë që është prodhues i produkteve objekt-prokurimi. KPP gjykon, se vetë autoriteti kontraktor për verifikime të mëtejshme i është drejtuar Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëse operatori “Argent Daci” PF është prodhues për produktet mish dhe nënproduktet e tij dhe a disponon stabilimente apo njësi në Sistemin e Informacionit Blektoral dhe Veterinar “Ruda” për prodhimin e produkteve si më poshtë: *Mish pule cilësi e parë, Mish pule deti cilësi e parë, Mish gjel deti cilësi e parë, Mish vici cilësi e parë, Mish deri cilësi e parë, Mish gici cilësi e parë, Mish keci cilësi e parë, Mish qengji cilësi e parë, Mish i grirë vici cilësi e parë, Kremvice cilësi e parë, Sallam vici cilësi e parë, Sallam derri cilësi e parë, Sallam popullor vici cilësi e parë Sallam popullor derri cilësi e parë, Proshutë vici cilësi e parë, Proshutë derri cilësi e parë, Fileto pule cilësi e parë*. Me shkresën nr. 1792/1 prot, datë 01.04.2022 me objekt “Kthim përgjigje, kërkesës për informacion për operatorin ekonomik “Argen Daci” PF, në lidhje me regjistrimin e tij në sistemin RUDA”, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural citon se: *“Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 488, datë 24.03.2022, me kërkesë për informacion në lidhje me operatorin ekonomik “Argent Daci”, nëse është i regjistruar në sistemin RUDA, ju bëjmë me dije se operatori është i regjistruar me tip njësi thertore, për therje të kafshëve të llojit gjedh dhe të imta, me kod njësie AL11341649T001, si dhe fermë blegtorale me kod fermë AL113416490520”*.*

Nga sa më sipër, në rastin konkret, edhe pas verifikimeve të kryera nga vetë autoriteti kontraktor, nuk rezulton e provuar referuar dhe përmbajtjes së kthim- përgjigjes së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, se operatori ekonomik ankimues nuk është prodhues i mallrave objekt-prokurimi, por përkundrazi referuar shkresës së datës 27.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 553/8 prot., datë 28.04.2022, me objekt “Në vijim të shqyrtimit të ankesës nr. 553/2022 prot, datë 16.03.2022” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion dhe dokumentacion provues nga operatori ekonomik ankimues “Argent Daci” PF, me përmbajte ndër të tjera si vijon: [...] *Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë informacion gjithashtu nga ana juaj,*

nëse subjekti im Argent Daci PF i cili zotëron licencat e shënuara më sipër, a quhet “Prodhues” në fushën e mishit dhe nënprodukteve të tij? [.....]. Në përgjigje të kërkesës së subjektit Argent Daci PF, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me shkresën nr. 1494/1 prot., datën 15.03.2022, sqaron se: **“Për sa më sipër cituar Subjekti Argent Daci kryen aktivitet prodhues/përpunues të produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij (për njerëz) në fushën e ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi”**.

Sa më sipër, Komisioni gjen të provuar se referuar shkresës nr. 1494/1 protokolli datë 15.03.2022 të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, i cili në përputhje me nenin 61 e vijues të ligjit nr. 9863/2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar është institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë kryen veprimtari inspektuese, teknike dhe shkencore, në përputhje me këtë ligj dhe ligjet e tjera specifike, për sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe për mbrojtjen e bimëve, deklarohet se subjekti Argent Daci kryen **aktivitet prodhues/përpunues të produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij (për njerëz) në fushën e ushqimit, sipas legjislacionit në fuqi**.

Sa më sipër, arsyeja e skualifikimit për ankimuesin nuk qëndron, pasi referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE, si dhe verifikimit të kryer nga vetë autoriteti kontraktor, dhe operatori ekonomik ankimues rezulton, se ky i fundit e plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit si prodhues, përpunues i produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij. Në rastin konkret, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor, ashtu si edhe vetë autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën mbi dokumentet e procedurës së prokurimit, për dorëzimin e deklaratës, shtrihet *stricto sensu* në rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës **nuk është prodhues, por do të përmbush kërkesat e AK me kontrata furnizimi për të gjithë artikujt objekt prokurimi**.

Kështu, autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë a-priori dhe në mënyrë sipërfaqësore por të analizojë në themel dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në garë. Kështu, rezulton e provuar se me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, operatori ekonomik rezulton se shfaqet në cilësinë e prodhuesit/përpunuesit të mishit dhe nënprodukteve të tij (për njerëz) në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërkohë rezulton se po sipas dokumenteve të garës nuk ekziston asnjë dokument tjetër i kërkuar nga autoriteti kontraktor për të bërë ndarjen midis operatorëve ekonomikë që shfaqen në cilësinë e prodhuesit ose të atyre që do të garantojnë furnizimin me mallra referuar kontratave të furnizimit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Olta Sharra” PF, me argumentin se: *“Në këtë procedurë prokurimi Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik Olta Sharra PF i cili nuk përmbush kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor konkretisht nuk plotëson kriteret e veçantë të kualifikimit, kapaciteti profesional, Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Në dokumentet standarde të tenderit, seksioni 2.2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1 Kapaciteti*

profesional i operatorëve ekonomike thuhet: a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1.B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018). Nga verifikimi në ëeb-in në Qendrën Kombëtare të Biznesit, lidhur me licencat aktive, të kategorisë II.1.A subjekti “Olta Sharra” PF, zotëron licencat e mëposhtme:1. LN-0459-04-2020 Kodi: II.1.A Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhimi, përpunim, ambalazhim, etiketim, shpërndarje të produkteve ushqimore. Kufizime specifike: Paketim, ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell). Pra, licencat profesionale përkufizimin e mallrave duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Licenca e mësipërme nuk është në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nënproduktet te tij” pasi ka kufizime specifike dhe shërben për paketimin, ambalazhimin e produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell). Sa me sipër, kjo licence nuk përmbush piken 2.1 Kapaciteti Profesional dhe operatori ekonomik Olta Sharra PF duhet s’kualifikuar. 2. LN-0077-02-2020 Kodi: II.1.A Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Shërbim Catering). Pra, licencat profesionale për furnizimin e mallrave duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Licenca e mësipërme nuk është në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nënproduktet te tij” pasi ka kufizime specifike dhe shërben për paketimin, ambalazhimin e produkteve ushqimore (Shërbim catering). Sa me sipër, kjo licence nuk përmbush piken 2.1 Kapaciteti Profesional dhe operatori ekonomik Olta Sharra PF duhet s’kualifikuar. 3. LN-9102-02-2015 Kodi: II.1.A. Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Katering). Pra, licencat profesionale për furnizimin e mallrave duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Licenca e mësipërme nuk është në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nënproduktet te tij” pasi ka kufizime specifike dhe shërben për paketimin, ambalazhimin e produkteve ushqimore (Shërbim catering). Sa më sipër, kjo licence nuk përmbush pikën 2.1 Kapaciteti Profesional dhe operatori ekonomik Olta Sharra PF duhet s’kualifikuar. Pra, licencat e mësipërme nuk janë në përputhje me objektin e kontratës “Blerje mish dhe nënproduktet te tij” pasi emërtimin përshkrues të veprimtarisë e kanë për (sheqer, oriz, miell) dhe për shërbim catering sikurse është shprehur qartë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në pikën 1 të shkresës nr. 411/1 prot datë 04.03,2022, “...Licencat me kodin II.1.A me aktivitet Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz “Restorant”, “Katering”, “Bar- Restorante”, “Furre buke” etj. nuk kanë të bëjnë me tregtimin e mishit të freskët. Sa më sipër, operatori ekonomik nuk plotëson kriterin seksioni 2.2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomike thuhet: Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe duhet të s’kualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik”, përcaktohet kriteri si më poshtë:

- I. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1.B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Për ushqimin”, konkretisht neni 19, për çdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqes tabelen me informacion si me poshte:

Nr.	Vendndodhja	Statusi	Nr. i regjistrit të posaçëm
1		Pronesi/qira/perdorim	
Etj.		Pronesi/qira/perdorim	

Detyrimisht duhet qe cdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Stabilimenti/stabilimentet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Olta Sharra” PF në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakti i Regjistrit Tregtar.
- Deklaratë për ambientet në disponim pika 2.1, nënpika 1 me përmbajtje si vijon si dhe licencat: Shoqëria “Olta Sharra” PF ka në disponim ambientet sipas tabelës së mëposhtme në të cilat ushtron veprimtarinë e saj si dhe ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin si më poshtë vijon.
 1. Rruga Ismail Zyma, Lagjia Haxhias, Elbasan (statusi me qira); LN-9102-02-2015; PN-6213-01-2018; LN-9900-01-2020.

2. Rruga Elbasan-Librazhd, Labinot Fushë Mengel, (statusi me qira); LN-0459-04-2020; PN-9962-04-2020.
3. Rruga Elbasan – Labinot Fushë, (statusi me qira); LN-1471-11-2020.
4. Rruga 11 Nëntori, Lagjja Gurakuqi, Elbasan, (statusi me qira); LN-0077-02-2020; PN-6212-01-2018.
5. Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-9102-02-2015 dhe me miratim kërkese me Nr. 80/2 prot, datë 15.01.2018 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (katering).
6. Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-0459-04-2020 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim, përpunim ambalazhim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, Paketim ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell).
7. Licencë me Kodin II.1.B (1) LN-1471-11-2020 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (Mish dhe nënproduktet të tij).
8. Licencë me Kodin III.1.A (1) PN-6212-01-2018 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Leje mjedisi e tipit C për Gatim dhe tregtim i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme.
9. Licencë me Kodin II.1.C (1) LN-9900-01-2020 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim Primar fruta perime.
10. Licencë me Kodin III.1.A (1) LN-6213-01-2018 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Leje mjedisi e tipit C për Gatim dhe tregtim i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme.
11. Licencë me Kodin III.1.A (1) LN-9962-04-2020 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Leje mjedisi e tipit C për Gatim dhe tregtim i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme.
12. Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-0077-02-2020 dhe me miratim kërkese me Nr. 278/2 prot, datë 06.02.2020 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (shërbim katering).

III.2.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.2.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.6. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orinetuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emertimi i veprimtarise(ve) specifike te licencuara sqarohet se: a) *Ketu vendoset emertimi i veprimtarise specike kur kjo eshte e kodifikuar.* b) *Kur subjekti ka kerkuar te ushtroje me shume se nje veprimtari specifike, ketu vendosen emeritimet e te gjitha atyre veprimtarive specifike qe ka kerkuar te licencohen.* c) *Nese keto shenime kerkojne me shume se 250 karaktere atehere vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkelidhur Nr.....”*

III.2.7. Në nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes” është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë”.*

III.2.8. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.*

III.2.9. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht:

Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare

6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjiëno-sanitare.

III.2.10. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjetë qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të

Përbashkëta”, Fusha II “*Ushqimi dhe Shëndeti*”, Kategoria II.1 “*Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve*”, parashikohet shprehimisht:

1. *Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

2. *Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:*

a) *“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;*

b) *“Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;*

c) *“Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.*

3. *Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

4. *Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.*

III.2.11. Në nenin 17, “*Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet*” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “*Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë*”, parashikohet shprehimisht se:

1. *Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.*

2. *Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.*

3. *Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:*

a) *emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;*

b) *llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;*

c) *të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;*

ç) *vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimin apo përdorimit të së mirës;*

d) *të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;*

dh) *deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);*

e) *deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;*

ë) *adresën për komunikim;*

f) *listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.*

4. *QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.*

5. *Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.*

III.2.12. Në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. *Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.*

2. *Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:*

a) *emrin dhe stemën e QKL-së;*

b) *serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;*

c) *të dhënat për identifikimin e titullarit;*

ç) *llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;*

d) *vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);*

dh) *kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimin apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka);*

e) *afatin e vlefshmërisë;*

ë) *nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;*

f) *të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;*

g) *aneksin.*

3. *Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.*

III.2.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si

dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar se :*Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1.B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*” Referuar proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor për kriterin e mësipërm ka arsyetuar se: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.* Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se objekti i prokurimit të procedurës objekt-ankimi është **Blerje Mish dhe nënproduktet e tij**, dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar që për çdo stabiliment qe disponon (pronësi dhe/ose qira) ofertuesit duhet të paraqesin informacionin në një tabelë lidhur me vendndodhjen, statusin në pronësi/qira/përdorim, si dhe numrin e regjistrit të posaçëm, si dhe ka kërkuar që çdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence përkatëse. Akoma më tej, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me ligjin, do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 te ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Olta Sharra” PF në përmbushje të kriterit sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik ka dorëzuar Licencë e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. KPP vëren, se ankimuesi ka paraqitur licencat përkatëse **1- Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-9102-02-2015 dhe me miratim kërkese me Nr. 80/2 prot, datë 15.01.2018 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (katering). 2- Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-0459-04-2020 dhe me miratim kërkese me Nr. 1626/2 prot, datë 29.04.2020 me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike Prodhim, përpunim ambalazhim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, Paketim ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell)**, por me emërtim përshkrues të veprimtarisë specifike **Prodhim, përpunim, ambalazhim,**

etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve katering dhe Paketim ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell).

Kështu, në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. **Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës**”. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar se kërkesat e vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit duhet të jenë në proporcion me objektin e kontratës. Nga ana tjetër, vetë autoriteti kontraktor në arsyetimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit në lidhje me këtë kriter ka arsyetuar se **kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore**. Në rastin konkret, objekti i kontratës objekt prokurimi është blerja e mishit dhe nënprodukteve të tij, ndërkohë referuar licencave të dorëzuara në SPE nga ana e operatorit ekonomik, rezulton se ky i fundit disponon dy licenca me veprimtari specifike paketim, ambalazhim i produkteve ushqimore (sheqer, oriz, miell, dhe shpërndarje ushqimi katering). Gjithashtu, operatori ekonomik “Olta Sharra” PF ka dorëzuar edhe argumente dhe pretendime mbi ankesën e dorëzuar nga operatori ekonomik “Argent Daci” P.F. ndërkohë nuk ka parashtruar asnjë argument në lidhje me licencat e dorëzuar, por është mjaftuar me deklarin se shoqëria “ndër to edhe licecna kryesore e kërkuar II.1.A1 “Prodhim përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Me Vendimin nr. 457 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” rezulton se shërbimi katering është në kategorinë e kodeve të veprimtarive të Hotele, restorante dhe shërbime të shitjes me pakicë me kod: Shërbime katering **55520000-1**, ndërkohë kodet e përzgjedhura nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit janë: 03211300-6 - Oriz, 15111200-1 - **Mish viçi, 03221220-4** - Bizele, 03142500-3 - Vezë, 03311000-2 - Peshk, 15530000-2 - Gjalpë, 15542000-9 - Djathë i freskët, 15811100-7 - Bukë, pra në kategorinë e Produkteve ushqimore, pije, duhan dhe lidhura me to. Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orinetuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emërtimi i veprimtarisë-ve) specifike të licencuara sqarohet se: a) Këtu vendoset emërtimi i veprimtarisë specike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar ëe ushtrrojë më shumë se një veprimtari specifike, këtu vendosen emërtimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen. c) Nëse këto shënime kërkojnë më shumë se 250 karaktere atëherë vihet shënimi: Për llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....” Sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik është i licencuar për veprimtari të ndryshme nga ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Olta Sharra” PF është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Licencës së kategorisë II.1.A.1 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga verifikimi i tyre rezulton, se në Licencat II.1.A. me të cilat është pajisur ky operator ekonomik, veprimtarinë specifike të përshkruar në licencë e kanë për katering dhe për paketim ambalazhim të produkteve ushqimore sheqer, oriz dhe miell, ndërkohë që objekti i prokurimit

është mish dhe nënprodukte të tij. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesve dhe përzgjedhjen e tyre nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke kualifikuar në këtë mënyrë operatorë ekonomikë të cilët nuk disponojnë dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor. Gjykojmë, se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me licencat e kërkuara. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Sqarojmë se, kriteri për licencat duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjitha elementet e përcaktuara nga ligjvënësi si dhe të kërkuara dhe përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi, referuar mangësive të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të vërtetohet disponimi i licencës së kategorisë II.A.1, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave, që përmban licenca, si dhe të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Ndërkohë KPP gjykon, se fakti që subjekti ka dorëzuar licenca të kategorisë II.1.A, jo domosdoshmërisht do të thotë që është përmbushur kriteri, pasi veprimtaria specifike ashtu sikurse është përcaktuar dhe në nenin 23, “*Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes*” të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “*Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë*”, parashikohet shprehimisht se: 1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj. 2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna ndër të tjera *ç) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj*. Nga sa më sipër KPP gjykon, se licensimi i subjekteve kryhet për një veprimtari të caktuar të prodhimit, përpunimit, paketimit dhe shpërndarjes së ushqimeve. Në këtë kuptim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik “*Oltta Sharra*” PF qëndron, pasi ky i fundit nuk arrin të provojë se disponon licenca II.1.A me fushë veprimtarie specifike prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje të ushqimeve për njerëz, (mish dhe nënproduktet e tij).

III.2.14. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente, pasi ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “*Oltta Sharra*” PF nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e

përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”*, KPP gjykon se operatori ekonomik *“Olta Sharra”* PF duhet të kishte dorëzuar licencat e kategorisë II.1.A për sa i përket veprimtarisë specifike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ku është cituar se ***operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës.***

III.2.15. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik *“Olta Sharra”* PF do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit

[...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF mbi kualifikimin e shoqërisë “*Olta Sharra*” PF, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimin më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “*Olta Sharra*” PF do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Argent Daci*” PF për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-16642-12-29-2021, në 7 lote me objekt “*Blerje artikuj ushqimor*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 1,061,007,405 (një miliard e gjashtëdhjetë e një milion e shtatë mijë e katërqind e pesë) Lekë (pa TVSH) ose 8,815,282.53 (tetë milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e tre) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 29.12.2021 është 120.36 lekë)., **Loti 3** me Nr. REF-16650-12-29-2021, me objekt “*Blerje mish dhe nënproduktet e tij*” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj, me fond limit 314,572,580 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*Argent Daci*” PF, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “*Ota Sharra*” PF dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Argent Daci*” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri